

## DEKLARATË ME INFORMACION PËR VAKSINËN

# Vaksina pneumokokale polisakaride (PPSV23): Çfarë duhet të dini

Shumë deklarata me informacion për vaksinën janë të disponueshme në gjuhën spanjolle dhe në gjuhë të tjera. Shih [www.immunize.org/vis](http://www.immunize.org/vis)

Hojas de información sobre vacunas están disponibles en español y en muchos otros idiomas. Visite [www.immunize.org/vis](http://www.immunize.org/vis)

## 1 Pse të vaksinohem?

Vaksina pneumokokale polisakaride (PPSV23) mund të parandalojë **sëmundjen pneumokokale**.

**Sëmundja pneumokokale** i referohet cilësdo sëmundje të shkaktuar nga bakteret pneumokokale. Këto baktere mund të shkaktojnë shumë lloje sëmundjesh, përfshirë pneumoninë, që është një infeksion i mushkërive. Bakteret pneumokokale janë ndër shkaqet më të zakonshme të pneumonisë.

Përveç pneumonisë, bakteret pneumokokale mund të shkaktojnë edhe:

- Infeksion të veshit
- Infeksion të sinusit
- Meningjit (infeksion të indit që vesh trurin dhe palcën kurrizore)
- Bakteremi (infleksion në qarkullimin e gjakut)

Sëmundja pneumokokale mund të zërë cilindo, por fëmijët nën 2 vjeç, personat me sëmundje të caktuara, personat 65 vjeç e lart, dhe personat që pijnë duhanin janë ata me rrezikun më të lartë.

Pjesa më e madhe e infeksioneve pneumokokale janë të lehta. Megjithatë, disa prej tyre mund të rezultojnë në probleme afatgjata, të tilla si dëmtim i trurit apo humbje e dëgjimit. Meningjiti, bakteremia, dhe pneumonia të shkaktuara nga sëmundja pneumokokale mund të jenë me pasoja fatale.

## 2 PPSV23

PPSV23 mbron nga 23 lloje bakteriesh që shkaktojnë sëmundjen pneumokokale.

PPSV23 rekomandohet për:

- Të gjithë **personat madhorë të moshës 65 vjeç e lart**,
- Cilindo që është **2 vjeç e lart me gjendje të caktuar mjekësore që mund të çojë në rrezik të shtuar për sëmundje pneumokokale**.

Pjesa më e madhe e njerëzve kanë nevojë për vetëm një dozë PPSV23. Një dozë e dytë PPSV23, dhe një lloj tjetër i vaksinës pneumokokale e quajtur PCV13, rekomandohet për grupe të caktuara me rrezik të lartë. Ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor do t'ju japë më shumë informacion.

Personat që janë 65 vjeç e lart duhet të marrin një dozë PPSV23 edhe nëse e kanë marrë tashmë një ose më shumë doza të vaksinës para se të arrijnë moshën 65 vjeç.

## 3 Flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.

Tregojini ofruesit tuaj të vaksinës nëse personi që merr vaksinën:

- Ka pasur **një reaksion alergjik pas marrjes të një doze të mëparshme PPSV23**, ose ka ndonjë **alergji të rëndë, kërcënuese për jetën**.

Në disa raste, ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor mund të vendosë ta shtyjë në kohë vaksinimin PPSV23 në një vizitë të ardhshme.

Personat me gjendje të lehta sëmundjeje, si i ftohët, mund të vaksinohen. Personat që janë në gjendje të sëmurë në nivel të moderuar ose të rëndë, zakonisht, duhet të presin deri sa të rimëkëmben para se të vaksinohen me PPSV23.

Ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor do t'ju japë më shumë informacion.



U.S. Department of Health and Human Services  
Centers for Disease Control and Prevention

## 4 Rreziqet e një reaksioni ndaj vaksinës

- Skuqje ose dhimbje në vendin ku është bërë vaksina, ndiheni i lodhur, temperaturë ose dhimbje të muskujve janë shenja që mund të shfaqen pas PPSV23.

Disa herë njerëzve u bie të fikët pas procedurave mjekësore, përfshirë vaksinimin. Tregojini ofruesit të shërbimit nëse ndjeni marrje mendsh apo ju ndryshon shikimi apo keni një zhurmë tingëlluese në vesh.

Ashtu sikurse edhe me çdo barnë, ka një mundësi shumë të largët që vaksina të shkaktojë një reaksion të rëndë alergjik, lëndime të tjera të rënda, apo vdekje.

## 5 Si veprohet në rast se ka një problem të rëndë?

Mund të ndodhë një reaksion alergjik pasi personi i vaksinuar të jetë larguar nga klinika. Nëse shihni shenja të një reagimi të rëndë (urtikarie, ënjtje të fytyrës dhe të fytit, vështirësi në frymëmarrje, rrahje të shpejta të zemrës, marrje mendsh, apo dobësi), telefononi urgjencën **9-1-1** dhe çojeni personin në spitalin më të afërt.

Për shenja të tjera që janë shqetësim për ju, telefononi ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.

Reaksione të dëmshme negative duhet të raportohen në Sistemin e Raportimit të Ngjarjeve të Dëmshme Negative nga Vaksina (VAERS). Zakonisht, këtë raport e dërgon ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor, por mund ta bëni edhe vetë. Vizitoni faqen e internetit të VAERS-it [www.vaers.hhs.gov](http://www.vaers.hhs.gov) ose telefononi **1-800-822-7967**. *VAERS-i shërben vetëm për raportimin e reaksioneve, dhe stafi i VAERS-it nuk japin këshilla mjekësore.*

## 6 Si mund të mësoj më shumë?

- Pyesni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.
- Telefononi departamentin e shëndetit në rang lokal apo shteti.
- Kontaktoni Qendrën për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC):
  - Telefononi **1-800-232-4636 (1-800-CDC-INFO)** ose
  - Vizitoni faqen e internetit të CDC [www.cdc.gov/vaccines](http://www.cdc.gov/vaccines)

